



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.467/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.07.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kadiu” sh.p.k nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.

**Ankimues:**

“Kadiu” shpk  
Autostrada Tiranë-Durrës, Km.3, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Vlore  
Lagja “Partizani”

**Subjekt i Interesuar:**

“Alstezo” shpk  
Blv Zogu I, Nr.34/1 Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.03.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.

II.2. Në datën 16.04.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 17.04.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- |             |           |                |
|-------------|-----------|----------------|
| - Andi Hamo | pa ofertë | I skualifikuar |
| - Kadiu     | 1,634,360 | I skualifikuar |
| - Alstezo   | 1,772,850 | I kualifikuar  |

II.4. Në datën 17.04.2018 operatori ekonomik “Kadiu” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *operatori ekonomik nuk ka vertetuar me dokumentate paraqitura qe pika e servisit e mare me qera permbush te gjitha kerkesat dhe kriteret e AK. Te gjitha faturat dokanore qe jane paraqitur nga operatori ekonomik tregojne pronesine e mjeteve por jo prezencen e tyre ne servisin e mar me qera.*

II.5. Në datën 24.04.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Dëshiroj tju kujtoj se ne si operator ekonomik me më shumë se 25 vjet eksperiencë në treg i kemi marrë shumë seriozisht kërkesat e paraqitura nga AK në DST e publikuar në faqen zyrtare të APP ku janë evidentuar me pika dhe shumë qartë kërkesat për tu plotësuar dhe i jemi përmbajtur me shumë rigorozitet atyre në plotësimin e dokumentacionit. Ndërkohë vërejmë se në refuzimin tuaj nuk ka asnjë referencë ose pikë ku ne të shohim se cila nga pikat nuk është plotësuar. I cuditshëm është fakti për distancën e kërkuar të servisit. Ndodh shpesh që institucione të tilla si spitalet ku emergjencat e punës dhe shërbimi ndaj pacientëve bën që servisi të kërkohet të jetë sa më pranë institucionit por në rastin tuaj servisi kërkohet jo brenda vlorës por 40 km larg fiks distanca ku ndodhet servisi i operatorit të kualifikuar. I kemi plotësuar kërkesat për dokumentacion dhe kemi të gjithë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të plotë të të gjitha kërkesave për riparimin e automjeteve.*

II.6. Në datën 24.04.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1727 prot i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 03.05.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në datën 10.05.2018 ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke publikuar njëherazi “Njoftimin e Fituesit” në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.2019 prot datë 11.05.2018 protokolluar me tonën me nr.854/2 datë 16.05.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit objekt ankimi.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kadiu” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “operatori ekonomik nuk ka vertetuar me dokumentate paraqitura që pika e servisit e marë me qera përmbush të gjitha kërkesat dhe kriteret e AK. Të gjitha faturat doganore që janë paraqitur nga operatori ekonomik tregojnë pronesinë e mjeteve por jo prezencën e tyre në servisin e marë me qera”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të publikuar nga autoriteti kontraktor me datë 03.04.2018 modifikohet kriteri si më poshtë:

#### **ISHTE**

*2.5.1 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht, pajisje teknike të nevojshme bashkëkohore për realizimin e kontratës, si vijon:*

*- të disponoj repartet përkatëse, motorist, elektroaut, gomist dhe të jete i pajisur me të gjitha pajisjet përkatëse.*

- te mbuloje ne furnizim dhe ne kohe sa me shpejte te gjithë gamen e artikujve dhe shërbimeve te kerkuara sipas llojshmerise se mjeteve qe disponon ndermarrja. Per plotesimin e ketij kriteri te paraqese deklarate me shkrim perfaqesuesit ligjor i Op.Ekonomik.

- te disponoje bankoprove portative per pompat e naftes, e shoqeruar me fotografi

-te disponoje makineri per konvergjencen e sistemit te drejtimit si dhe te balancimit statik e dinamik te rrotave te para drejtuese,e shoqeruar me fotografi.

-reparti(servisi) te jete i pajisur minimalisht me 3(tre) ura ngritese per automjete,ku 1 (nje) ure ngritese te jete per mjete me kapacitet mbajtes mbi 3.5 ton.

#### 2.5.2

- Te disponoje aparat per furnizimin me alkool dhe nxjerrjen e ajrit te sistemit te frenimit.

- te disponoje kompjuter per diagnostikimin e automjeteve, i pajisur me programe per shumllojshmeri automjetesh.

Per pajisjet e mesiperme te paraqes dokumentet qe ka ne pronesi ose me qera.(Dokumenta qe vertetojne se keto pajisje i ka ne pronesi te paraqitet fature blerje brenda vendit,ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit,faturat e blerjes te jene te shoqeruara me dokumentin e cdoganimit te tyre ne emer te shoqerise ose te marra ne kontrate me qera.

### **BËHET**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht, paisje teknike te nevojshme bashkekohore per realizimin e kontrates, si vijon:

- 4 (kater) ura ngritese per furgonat (me krah te gjate) me kapacitet jo me pak se 4ton
- Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motorr të automjetit
- Linje kontrolli teknik te paisur me ure perkatese per ngritje dhe kontroll te mjetit
- Paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit te automjetit
- Paisje per kontrollin dhe testimin e sistemit amortizimit & vibrimeve te automjetit.
- Paisje per kontrollin dhe testimin e difekteve (xhokove) ne sistemin e drejtimit.
- Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit.
- Paisje per kontrollin&balancimin e disqeve&gomave automjetit (ballancimi rrotave).
- pajisje te levizshme (portabile) per ndezje emergjente te mjetit 12v & 24v.
- Paisje per kontrollin dhe realizimin e gjeometrise (konvergences) rrotave te mjetit te kompletuara perkatesisht me urat me kater kollona te pershtatshme ne kapacitet per fuoristradat dhe furgonat sipas listes automjeteve referuar specifikimeve ne DT.
- Paisje per nderrimin e fluidit (alkoolit) per komplet sistemin e frenimit.
- Paisje per venien ne faze te motorrit te mjetit.
- Paisje per testimin e sistemit te ftohjes motorrit.
- Pajisje per kontrollin dhe mbushje me gaz te sistemit A/C

*Ne lidhje me kete kriter (pika 2.3.6) operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:*

*- Dokumenta qe vertetojne se keto paisje i ka ne pronesi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndersa ne rastet e blerjes jashte vendit, faturat e blerjes te jene te shoqeruar me dokumentin e çdoganimit te tyre ne emer te shoqerise) ose te marra me kontrate me qira .*

*- Foto te ambjenteve te autoservisit ne te cilin te jenë te montuara pajisjet e sipershenuara, te cilat do te verifikohen nga AK perpara klasifikimit te ofertave.*

III.1.2.Referuar arsyes së skualifikimit njoftuar rregullisht operatorit ekonomik nëpërmjet SPE rezulton se skualifikimi i ankimuesit është bërë me pretendimin se “*operatori ekonomik nuk ka vertetuar me dokumentate paraqitura qe pika e servisit e mare me qera permbush te gjitha kerkesat dhe kriteret e AK. Te gjitha faturat doganore qe jane paraqitur nga operatori ekonomik tregojne pronesine e mjeteve por jo prezencen e tyre ne servisin e mar me qera*”.

III.1.3. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë sqarohet se: *Lidhur me këtë kriter të kërkuar nga ana jonë nga verifikimi i bërë nga KVO përpara klasifikimit të ofertave rezulton se ju si operator ekonomik nuk keni paraqitur bashkë me ofertën tuaj foto të servisit me qera në të cilin të jenë të montuara pajisjet e sipërshënuara. AK nuk ju ka skualifikuar për pronësitë tuaja në serviset që dispononi por të vërtetoni që këto pajisje janë në servisin që do të vene ambulancat për të marrë shërbimin.*

2.3.6. *Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore tipi C (III.1A) për riparimin e pajisjeve motorike. Lidhur me këtë kriter të kërkuar nga ana jonë ju nuk keni paraqitur dokument ku të provoni se servisi i marrë me qera përvec mangësisë së provës që ky servis i ka këto mjete disponon leje mjedisore tipi C (III.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike.*

.....

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për disponimin e servisit ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Qeraje Nr.531 Rep, Nr.118/1 Kol datë 25.02.2017 ndërmjet subjektit E.M në cilësinë e qeramarrësit dhe shoqërisë Kadiu shpk në cilësinë e qeradhënësit me objekt pajisjet e repartit të autoriparimit të mjeteve për ti përdorur për nevoja të aktivitetit të tij privat
- Foto të Pajiseve të marra me qera (26 foto)
- Deklarata Doganore të Pajisjeve

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:“*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në*



*procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.7. Referuar kriterit të kualifikimit rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë pajisje teknike të nevojshme për realizimin e kontratës si më sipër cituar. Për të provuar këto kapacitete operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë - *Dokumenta që vertetojnë se keto pajisje i ka në pronësi (te paraqitet fature blerje brenda vendit, ndërsa në rastet e blerjes jashtë vendit, faturat e blerjes të jene të shoqëruar me dokumentin e çdoganimit të tyre në emër të shoqërisë) ose të marra me kontratë me qira si dhe Foto të ambienteve të autoservisit në të cilin të jenë të montuara pajisjet e sipërshënuara, të cilat do të verifikohen nga AK përpara klasifikimit të ofertave.*

III.1.9. Referuar sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik ankimes me dokumentacionin e paraqitur plotëson kriteret e kualifikimit të sipërcituara. Konkretisht operatori ”Kadiu” shpk ka dorëzuar kontratë qeraje, deklarata doganore si dhe foto të pajisjeve me anë të së cilës dëshmon se disponon pajisjet teknike të kërkuara të nevojshme për realizimin e kontratës. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se ankimesi me *faturat doganore të paraqitura tregon pronesine e mjeteve por jo prezencen e tyre në servis*in e mar me qera, KPP konstaton se në kriterin e kualifikimit autoriteti kontraktor i ka rezervuar të drejtën vetes për verifikimin e prezencës së mjeteve në servis përpara klasifikimit të ofertave. Nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk rezulton të jetë mbajtur asnjë procesverbal për verifikimin e këtyre pajisjeve në servis. Në këtë kuptim KPP gjykon se me dokumentacionin e paraqitur ankimesi dëshmon se disponon në një nga format ligjore në rastin konkret me qera pajisjet teknike të kërkuara. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor në kthim përgjigjen drejtuar ankimesit se nuk janë paraqitur foto të servisit me qera në të cilin të jenë të montuara pajisjet e sipërshënuara KPP gjykon se autoriteti kontraktor, në kushtet kur të gjitha fotot e pajisjeve dhe mjeteve si dhe deklaratat doganore të pajisjeve janë dorëzuar, nga operatori ekonomik ankimes, në përputhje me kriterin e kualifikimit, ka pasur mundësi të bënte verifikimin në vënd të pajisjeve në servis in e disponuar nga operatori ekonomik ankimes duke mbajtur dhe procesverbalin përkatës.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

III.2. Gjithashtu KPP konstaton se në kthim përgjigjen drejtuar ankimesit KSHA ka shtuar arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimes të cilat nuk i janë komunikuar në momentin e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga KVO. Konkretisht është shtuar arsyeja e skualifikimit 2.3.6. *Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore tipi C (III.1A) për riparimin e pajisjeve motorike. Lidhur me këtë kriter të kërkuar nga ana jonë ju nuk keni*

paraqitur dokument ku të provoni se servisi i marrë me qera përvec mangësisë së provës që ky servis i ka këto mjete disponon leje mjedisore tipi C (III.1.A) për riparimin e pajisjeve motorike.

III.2.1. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.” Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.2.2. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përbërësit, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e



*tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.*

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor ( rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A ( Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Në rastin konkret KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kadiu” shpk si dhe ka shtuar arsye të reja skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

III.2.4. Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni 78 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimes e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

III.3. Gjithashtu nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mbi fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se

në datën 10.05.2018 autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke publikuar njëherazi “Njoftimin e Fituesit” në Sistemin e Prokurimeve Elektornike.

III.3.1. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.3.2. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”

Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se “Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.”

Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “ [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankesuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në datën 24.04.2018 i ka kthyer përgjigje palës ankimuese duke refuzuar ankesën. Me refuzimin e ankesës nga Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe dhënia e një vendimi të arysetuar nga ky i fundit nuk heq pezullimin e procedurës së prokurimit parashikuar nga neni 63 pika 3 e LPP. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkëlur afatet procedurale të ankimit duke vijuar me hapat e mëtejshëm të publikimit të njoftimit të fituesit, brenda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimues i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimues pranë

Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së. Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatorët ekonomikë ankimues kanë qenë brenda afateve kohore të ankimit pranë K.P.P si në momentin e publikimit të njoftimit të fituesit të procedurës së prokurimit gjithashtu edhe në momentin e dorëzimit të ankesës pranë KPP.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë aktin administrativ të njoftim fituesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi .

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kadiu” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-58914-03-27-2018 me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, me fond limit 1 799 100 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 16.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Kadiu” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e datës 10.05.2018 për “Njoftim Fituesin”.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kadiu” shpk
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 854 Protokolli, Datë 03.05.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**